




Republika e Kosovës

**Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr. 12-060-1061 dt. 09.01.2020

PROCESVERBALI

**I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 20.12.2019, ora 10⁰⁰.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.**

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi.

Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin, Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për SHMS; - Arsim Haxhiu, Drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit: Flutra Avdiu, nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Milaim Hajdari.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 15.11.2019.
2. Prezantimi i anëtarëve nga Komisioni i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore për konkurrentët e për zgjedhur në bazë të Konkursit dhe aprovimi i tyre.
3. Propozim Vendim për Arovim: Plani Komunal për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor (PKZHIKPSH) Drenas-it 2020 – 2024.
4. Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024.
5. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2019.
6. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik të pjesëve të ngastrave kadastrale, nëpër të cilat do të kalon rruga “Adem Jashari” e cila fillon nga Feronikeli nëpër Poklek, Korroticë e Ultë e deri në Korroticë të Epërme (te Kroni i Mbretit).
7. Arovimi i Planit të Punës për vitin 2020, i Kuvendit Komunal.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës, pasi nuk ka diskutime, vërejtje, apo sugjerime kalojmë në aprovimin e rendit të ditës.

Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Kalojmë tek **Pika e parë;** Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 15.11.2019. E hapim për diskutim. Fjalën e ka Florentina Elezi rreth procesverbalit ku deklaroi se mungon fjala ime që kamë diskutuar për shkak mungesës së incizimit.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: E keni mundësin me sjellë diskutimin përmes emajlit e ne e plotësim procesverbalin prapë me diskutimet e juaja. Meqë nuk ka diskutime tjera kalojmë në votim me plotësim ndryshime.

Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Pika 2. Prezantimi i anëtarëve nga Komisioni i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore për konkurrentët e përzgjedhur në bazë të Konkursit dhe aprovimi i tyre.

Kryesuesi Labinot Halilaj : Hapë diskutimin, ky propozim vendim është rishpallur .

Fjalën për prezantim e ka zonja Morina,

Fitore Morina: Kjo është rishpallur , un jam pjesë anëtare e komisionit ky propozim vendim është rishpall për arsye se nuk kanë ardhur të gjithë kandidatet, nuk kanë qenë as pesë kandidatë prezent duhet me qenë të paktën pesë kandidat për këtë arsye është rishpallur përsëri edhe herën e dytë kemi arrit dhe kemi zgjedhur këta. Kanë aplikuar dymbëdhjetë ose trembëdhjetë i kemi marrur në intervistë me gojë dhe janë zgjedhur këta.

Kryesuesi Labinot Halilaj : Nëse nuk ka dikush diçka ju kisha kërkuar me rekomandua për kuvend , thjeshtë të gjitha procedurat janë bërë për përzgjedhjen e tyre është fatbardhësi se e kemi edhe një anëtare të tyre këtu dhe e dha sqarimin ne lidhje me rishpallje . Meqë nuk ka diskutime tjera kalojmë në votim

Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Pika 3 është Propozim Vendim për Aprovim: Plani Komunal për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor (PKZHIKPSH) Drenas-it 2020 – 2024. Hapim pikën e tretë për diskutim. Ia japim fjalën për sqarim Drejtorit për SHMS. Arsim Haxhiut dhe jeni të lirë të kyceni në diskutim .

Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Arsim Haxhiu: Sqaron në pika të shkurtra. Bazuar në ligjin për shëndetësi 04/L-125 dhe udhëzimin Administrativ 08, 2017 e cila tani më edhe si terma janë bërë mjaftë të shpeshtë edhe ne mbledhjet e kuvendit. Përgjigja për ofrimin kujdesit parësor shëndetësor dhe vlerësimin e gjendjes shëndetësore ne territorin tonë sigurisht që është Komuna, dhe kjo përgjegjësi determinon që të bën përmasimin e kujdesit parësor shëndetësor , respektivisht fillimin e implementimit të mjekësisë dmth përmes konceptit mjekësisë familjare . Duke pas parasysh gjendjen shëndetësore të popullatës , planifikimin , kontrollin , vlerësimet e parametrave , zbatimin e masave , faktikisht është prioritet i

mekanizmave planifikues . Plani është mundësuar paraprakisht në fazën parapërgatitore nga agjensioni Zviceran për zhvillim bashkëpunim SDC-ja natyrisht përmes AQH-së. AQH-ja ka qenë një OJQ e cila ka përcjellë të gjitha të dhënat përmes mekanizmave të saj në mënyrë të pavarur nga ajo se çka mendojmë ne, nga ajo se çka mendon stafi shëndetësor , natyrisht duke harrur parasysh opinionet e Qytetarëve , OJQ-ve , Shoqërisë Civile, Administratorëve të fshatit , Pacientëve , të gjitha këto janë të përmbledhura gjatë vitit 2018. Ky plan përfshin një objektiv të përgjithshëm, përfshin tri objektiva specifike , diku rreth 15, rezultate të tanishme , dhe 101 aktivitete të cilat do duhet të realizohen respektivisht në fillim gjatë kësaj periudhe kohore 2020-2024. Në propozim vendim diku pika 3 nëse nuk gabojmë , është se ky plan do të jetë plan dinamikë , që nënkupton do të jetë i vlerësueshëm në tri komponentë, në aspektin cilësor , sasior dhe kohor, duke marrur parasysh të gjitha procedurat bashkëkohore të hartimit të një plani. Nëse keni ndonjë pyetje ose diskutim mundemi të sqaronim diçka më konkrete. Propozim vendimi dhe plani është i hapur për ndryshime eventuale në çdo kohë nga niveli qendror. Në disa komuna në dy ose tri komuna është refuzuar ky plan , për arsye është quajtur si plan strategjik .

Kryesuesi Labinot Halilaj : Unë e përgëzoj për punën që ka bërë drejtori me gjithë ekipin , sigurisht plane të tilla është mirë me mbështet dhe normal me kontribui nëse mundemi me kontribui. Burimi ka fjalën .

Burim Bujupi : Nuk dëgjohet zëri .

Kryesuesi Labinot Halilaj :Përgjigjet Doktorri,

Dr.Arsim Haxhiu: Plani përfshin risistemimin edhe përcaktimin e detyrave dhe vendeve të punës gjatë një periudhe të themi njëzet vjeçare gati mbas lufte. Një prej problemeve të identifikuar të cilat janë identifikuar mjaft saktë është një prej problemeve që është pengesë e menaxhmentit të QKMF-së në kuptimin e ofrimit të shërbimeve cilësore, dhe masat të cilat janë ndërmarr fillimisht vitin e kaluar për zgjatjen e orarit të punës deri në orën, 21:00 të kujdesit parësor shëndetësor , masë andej qendra e dytë që është bërë 24 orësh në Komoran , kanë qenë dy masa të domosdoshme në mënyrë që të lirohet presioni i madh natën në shërbimin e emergjencës në Drenas. Megjithatë ka nevojë edhe për çështje tjera dhe njëra prej këtyre është se puna do të jetë 12 orësh, dhe sistemimi do të shkon në bazë udhëzimit administrativ respektivisht në bazë të normave të përcaktuara një mjek në 2000,banor dhe një mjek dy infermier, është bërë zotimi në projekt janë detalizuar , Drenasi do të ketë diku 9 mjek me 18 infermier, e kam fjalën gjithmonë për mjekësi familjare. Secila qendër e shëndetësisë familjare do të ketë numrin e mjekëve në proporcion të drejtë me numrin e banorëve . Qëllimi i këtij plani në të ardhmen brenda kësaj periudhe katër vjeçare është që të ofrohen të gjitha shërbimet që ofrohen në Drenas. Ligji ua jep të drejtën të zgjedhin mjekun familjar. Në planin tonë e kemi vendosur që të kenë të drejtën e përzgjedhjes të mjekut familjar.

Kryesuesi Labinot Halilaj : Fjalën e ka zonja Elezi

Florentina Elezi : Unë i kam dy çështje të shkurtra , e para është sa i përket barnave , barnat esenciale si është gjendja në Drenas e pajisur me barna esenciale dhe a e keni paraparë psh. Unë e kam një rast kur kemi thirr emergjencën ka ardhur emergjenca dhe ka dërguar dikë me shku me ble barna , sepse nuk kanë qenë të pajisur me barna . Për mua kjo është shumë

shqetësuese sepse emergjenca kur të thërritet dmth është një rast emergjent dhe nuk është absurde me qen e pa pajisur me barna , fatmirësisht qe është kanë ne Drenas se me kanë me ndonjë fshat tash merrne me mend . E dyta ka të bëjë me diçka krejt tjetër . A është e përfshinë në këtë plan edhe motivimi i punëtorëve ? Për shkak se e shoh shumë të rëndësishme , sepse janë shumë pa motiv , nganjëherë vërehet ne sjelljen karshi pacienteve . Në çfarë forme është e përfshimë motivimi i punëtorëve ?

Dr. Arsim Haxhiu : Si që e cekta më parë është një qëllim që përfshin tri objektiva specifike , të cilat janë paraparë që 15 diku rezultate dhe mbi 101, dikun s'di a i kemi hequr apo shtuar 2-3 aktivitete dhe njëra prej tyre është edukimi shëndetësor i cili nuk nënkupton edukimin shëndetësor vetëm me qytetarin, me grupmoshat, me gjininë, por edukimi shëndetësor faktikisht pavarësisht përgatitjes qe ka profesionale e ka një diplomë , një licencë , që i jep të drejtën për punë profesioniste shëndetësore , në kuadër të saj hyjnë edhe shumë çështje tjera ndër to edhe motivimi është i përfshirë, krejt këto lidhen me standardizime. Ne kemi marrë një listë e problemeve në mesin e tyre është edhe sillja e pacienteve, karakterin e formimit të punëtorit shëndetësor prej mjekut , infermierit , që realisht ne do të duhet të ofronim at komoditetinë edhe punën pa presion. Sa i përket Barnave i gjeni ne pjesën e shtojcës qe jemi mbështetur ne vitet e fundit qe i ka falcifitu AQH-ja .

Fitore Morina: A ka ndonjë ndryshim apo ka shtim të dokëtorrave sepse është një numër i vogël.

Kryesuesi Kuvendit Labinot Halilaj : Po ndodhin disa pyetje që s'kanë të bëjnë me materialin që është. Mjekësia gjithkund ka qalu kapak edhe prapë është bërë shumë . Nuk ka përkundë në botë nëse nuk paguhet mej pas gjitha shërbimet me qenë në nivelin më të kënaqshëm , ndoshta krejt problemet e shëndetësisë kanë me u rregulluar një ditë kur të implimentohet ligji i sigurisë shëndetësore .

Burim Bujupi : Nuk dëgjohet zëri në minutat e par. Unë mendoi qe me u realizuar ky plan ka sfida ka punë por me pak gjë dhe pak vullnet majm me arrit shumë. Numri i doktorëve është një dhe numri i infermiereve është tre po më doket shumë pak. Unë mendoj që me e thjeshta qe mujm me implementu është që punëtorëve teknik me ia bërë orarin dy pjesë qe mos me ardh në ora 7 pcientat e Arllatit në Drenas. Sipas disa informatave që kam, nga Arllati keni dashur ta largoni laboratorin ? A mund të më jepni një përgjigjeje a është e vërtet a jo ?

Kryesuesi Labinot Halilaj : Fjalën e ka drejtori i drejtorisë për SHMS.

Dr. Arsim Haxhiu : Nuk dëgjohet zëri ... Ne nuk mundemi me marr mjek sa dojm edhe në qoftë se kemi mundësi. Mjek na vyen aq sa kem banor . Nga ana zyrtare ajo qe thua për laborator nuk qëndron. Ne Drenas na vyen gjithsej 29 mjek planifikuam e gjeni ne material, për kujdesin parësor shëndetësor eventualisht cilat sfida që do të mbetin për të ardhmen se si do të jetë shërbimi emergjencës e organizuar dmth 29 mjek, 58 infermier , ky është çelësi i strategjisë dhe planifikimi ka do të shkojmë na. Gjithmonë do mbështetmi ne standardet maksimale të cilat kërkohen.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Nëse nuk ka dikush diçka,
Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Pika 4 është Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024.

E hapim për diskutim . Fjala për drejtoreshën Flutura Avdiu.

Drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit : Flutura Avdiu: Ndër objektivat për vitin 2019, ka qenë edhe hartimi i planit lokal për cilësi të ajrit , të cilin Komuna e Drenasit më herët nuk e ka pasur dhe me vendim të kryetarit është themeluar ekipi komunal për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2020-2024, dhe pastaj me kordinimin e të dhënave është kontraktuar edhe një kompani përmes procedurave të prokurimit për të kordinuar të dhënat e ofruar nga grupi punues për hartimin e këtij plani. Komuna e Drenasit e ka hartuar planin dinamik për veprimin për cilësi të ajrit 2020-2024, i cili është një dokument planifikues strategjik për të adresuar zgjidhjet e problemeve të cilësisë së ajrit në nivel lokal për periudhën 5 vjeçare. Qëllimi i këtij plani është që ta definoj veprimet e menaxhimit të cilësisë së ajrit brenda territorit të komunës së Glogocit për periudhë 5 vjeçare, që ka objektiva specifike si që janë analiza e gjendjes ekzistuese dhe burimeve kryesore të ndotjes së ajrit, identifikimin e problemeve kryesore për përmasimin e cilësisë së ajrit , dhe planifikimin e afateve veprimeve dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së ajrit. Rekomandimet të cilat janë dhënë nga grupi punues, për përmasimin e ajrit të cilat duhet të ndërmerren janë: Të mos shfrytëzohen automjetet pa nevojë , të shfrytëzohet transporti publik, të bëhet pastrimi i rregullt i oxhaqeve , të prolongohen të gjitha aktivitetet publike ne ambientet e hapura vetëm në rastet kur janë emergjente, sipas nevojës të mbyllën përkohësisht Shkollat dhe Institucionet e Administratës në raste kur kemi lajmërim të tilla, të bëhet inspektimi i lartësisë së oxhaqeve të ekonomive familjare, të rritet kontrolli i inspeksioneve të subjekteve që menaxhon gomat e mbeturinave, të organizohet transporti i mallrave me automjete brenda Komunës dhe të bëhet një orar prej orës 07:30 të mëngjesit deri 18:00 të mbrëmjes. Të gjitha subjektet juridike që përdorin ngrohjen dmth pajisjet për djegëse ti kontrollojnë dhe të përcaktohen me standarde, me çka nuk do të lëshohen mjete ndotëse apo materie që ndikojnë në ndotjen e ajrit.

Burim Bujupi; A keni ndërmarr ndonjë mas për ndotësin gjigant Feronikelin ?

Drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit: Flutura Avdiu - Pjesa parë është pastrimi i kalueshmërisë së kamionëve, mbyllja e kamionëve pjesa e skorës është një shtresë që duhet ç'do transport i kamionëve të mos kaloj , shtimi i hapësirave të gjelbërta, filtrat duhet të pastrohen dhe të bëhet një kontroll e veçanet . Të gjitha këto rekomandime janë përfshirë ne përmasimin e ndotjes së ambientit nga Feronikeli.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; A ka ndonjë gjë në plan veprim që duhet me hy që ndikon direkt ne cilin e ajrit , që nashta në planin e veprimit nuk e kanë parapa . Përndryshe si iniciativ është perfektë . Ky është një planë që po llogaritet me u banë , edhe ne muajm me propozua diçka prej kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; fjalën e ka ,

Burim Bujupi; nuk dëgjohe zëri.

Drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit : Flutura Avdiu-
Afati i mbikëqyrjes dhe implementimit është i përcaktuar në plan. Sa i përket kompanis Feronikeli është kategori e tretë , kështu që mbikqyrja nuk i takon vetëm Komunës por i takon Departamentit për Mbrojtje të Mjedisit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit të Planifikimit Hapësinor. Kontrollat bëhen nga Ministria , leje ndërtimore , zgjerimi i kompanisë Feronikeli bëhet në kuadër të Ministrisë së tret.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Nëse nuk ka dikush diçka,
Votojmë; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet*

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; Pika 5 është Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2019. E hapim për diskutim . Nëse nuk ka e kishim me rekomandu për Kuvend .

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Nëse nuk ka dikush diçka,
Votojmë; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Mirato*

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; Pika 6 është Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik të pjesëve të ngastrave kadastrale, nëpër të cilat do të kalon rruga “Adem Jashari” e cila fillon nga Feronikeli nëpër Poklek, Korroticë e Ultë e deri në Korroticë të Epërme (te Kroni i Mbretit). Para së ta hapim diskutimin në pika të shkurtëra ia kaloj fjalën Drejtorit .

Drejtor i drejtorisë për Gjeodezisë për Kadastër dhe Pronë: Milaim Hajdari :Propozim vendimin qe kemi përgatit ka për qëllim duke pasur parasysh debatin që është mbajtur me publikun me qytetarët e asaj pjese, palët janë njoftuar me procedurën e shpronësimit e rendit është që përmes Kuvendit Komunal të shpallet sepse është në interes të përgjithshëm . Kjo rrugë , është bërë trase vite me parë mirëpo megjithatë Komuna është neglizhuar duke pasur parasysh investimet qe kanë qenë nga Ministria e Infrastruktura të Nivelit Qendror. Ajo që na ka përcjell këto vite sa ne kemi informacione është se rruga nuk ka qenë e kategorizuar , ka qenë e diskutueshme të bëhet rrugë regjionale në drejtim Drenas – Skenderaj , mirëpo me kalimin e kohës është ardhë në përfundim se rruga është mbetur rrugë lokale. Projekti është duke u zhvilluar dhe komuna është obligative të kryej procedurat e shpronësimit . Ka pas ankesa , pikërisht këto ankesa na obligojnë të shpallim interes të përgjithshëm , në momentin që shpallim interes të përgjithshëm Komuna në këtë rast Drejtoria për Kadastër është e obliguar ti përcill të gjitha procedurat në Ministrinë e Financave në Laboratin e Shpronësimit konkretisht në Ministrinë e Financave është në Departamenti Tatimit në Pronë.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Nëse nuk ka dikush diçka,
Votojmë; *7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Mirato*

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Pika e 7 është Aprovimi i Planit të Punës për vitin 2020, i Kuvendit Komunal. Hapim për diskutimin a ka dikush diçka .


Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Nëse nuk ka dikush diçka,
Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstënim s'ka. Mirato

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj;
Kalojmë tek pika e fundit; të ndryshme. Nuk ka diskutime atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11⁰⁰:46⁰⁰

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku-Subashi


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj